





**MODELI 3D I QYTETIT TË POGRADECIT
PËRFTUAR NGA TEKNOLOGJIA UAV**

Përdorimi i shërbimeve satelitore për evidentimin e dëmeve nga zjarri

Në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), ASIG ka kryer analizimin e ndryshimeve të ndodhura në ngjarjet e fatkeqësive natyrore nga zjarri, të cilat prekën zonat: “Bogë-Razëm-Dedaj-Malësi e Madhe”, “Borsh-Shën Vasil- Himarë-Delvinë”, “Dukat-Vlorë”, “Lurë-Zall Gjoçaj, Dibër”, “Mbreshtan, Dimal”, “Ploçë-Bashaj-Matogjin, Selenicë”, “Shkopet, Rrëshen”.

Me anë të përdorimit të teknologjisë së avancuar Remote Sensing, u ndërtuan hartat e zonave të prekura nga zjarri duke shtuar elemente, të cilët janë të rëndësishëm për:

- Vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin e riskut nga zjarri;
- Marrjen e masave strukturore për zvogëlimin e riskut;
- Vlerësimin e dëmit nga zjarri.



Publikime në Gjeoportalin Kombëtar



Informacion Gjeohapësinor për temën “Ortoimazheria”

ASIG ka përgatitur dhe publikuar në Gjeoportalin Kombëtar shtresën gjeohapësinore “UAV Ortofoto 2024-2025”, e cila përmban informacion të krijuar nëpërmjet teknologjisë UAV, me qëllim ofrimin e të dhënave të përditësuara për zonat me interes të lartë zhvillimi. Këto produkte gjeohapësinore janë përgatitur konform Standardit Shtetëror për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, tema: "Ortoimazheria", i miratuar me VKM- në nr. 397, datë 19.06.2019, duke siguruar përdorim të harmonizuar dhe të standardizuar të informacionit.



Kjo shtresë përfshin ortofotot e krijuara gjatë fotografimeve ajrore në:

- Dhërmi (14–15 tetor 2024);
- Kavajë (19–20 mars 2025);
- Lezhë (3–5 qershor 2025);
- Librazhd (1 korrik 2025);
- Shëngjin (14–16 korrik 2025);
- Pogradec (23–25 korrik 2025).

Ky informacion synon të ofrojë të dhëna të përditësuara dhe të besueshme, të cilat mund të përdoren për një gamë të gjerë aplikimesh nga zhvillimi i infrastrukturës dhe menaxhimi i fatkeqësive natyrore, deri tek ruajtja e mjedisit dhe planifikimi i përdorimit të tokës.



Informacion Gjeohapësinor mbi shpalljen “Ansambël Arkitektonik Urban” i një zone në qytetin e Konispolit



ASIG ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar informacion gjeohapësinor për shpalljen pasuri kulturore të paluajtshme “Ansambël Arkitektonik Urban” të një zone në qytetin e Konispolit, bazuar në VKM nr. 458, datë 31.07.2025, sipas planit të miratuar për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e pasurisë, duke ofruar informacion të detajuar mbi zonat përkatëse:

- [Ansambli Arkitektonik Urban, Konispol \(Zonimi\)](#);
- [Ansambli Arkitektonik Urban, Konispol](#);
- [Zona mbrojtëse e "Ansambilit Arkitektonik Urban", Konispol \(Zonimi\)](#);
- [Zona mbrojtëse e "Ansambilit Arkitektonik Urban", Konispol](#).

Publikimi i këtyre shtresave ofron një mjet të rëndësishëm për institucionet dhe publikun, duke mundësuar akses të drejtpërdrejtë në informacionin gjeohapësinor dhe duke mbështetur proceset e planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit të pasurive kulturore në qytetin e Konispolit.


Rilevim me teknologjinë UAV - Zona Pogradec

Në funksion të përmirësimit të planifikimit urban dhe administrimit të territorit, ASIG ka kryer një rilevim fotogrametrik të zonës urbane të Pogradecit përmes teknologjisë UAV (Unmanned Aerial Vehicle). Rilevimi mbulon një sipërfaqe prej 12,7 km² me rezolucion hapësinor prej 4 cm, gjë që garanton cilësi të lartë dhe detaje të imta për analizat gjeohapësinore në mjedisin urban.

Produktet e ofruara përfshijnë:

- Ortofoto
- DSM (Modeli Digjital i Sipërfaqes)
- DTM (Modeli Digjital i Terrenit)
- Izoipse

Të dhënat e përfthuara sigurojnë informacion të saktë dhe të detajuar për zonën e Pogradecit, duke mundësuar vlerësime të shpejta e të besueshme të terrenit dhe duke mbështetur hartimin e planeve urbanistike, projektimin e infrastrukturës, monitorimin e ndryshimeve në përdorimin e tokës, si edhe kryerjen e vlerësimeve topografike dhe atyre të riskut për vendimmarrje të informuara.




Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar

Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare me teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360°, ASIG ka realizuar fotografimin dhe publikimin në Gjeoportalin Kombëtar të rrugëve urbane të qytetit të Tepelenës. Gjatësia e aksit të mbuluar me fotografi 360° është 25 km. Ky informacion vizual i detajuar shërben si mjet mbështetës për planifikimin territorial, menaxhimin e infrastrukturës dhe monitorimin e zhvillimeve urbane.



Zgjerimi i Hartës Bazë – Zona Raban, Përmet



ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën "Harta Bazë", si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale për zonën rurale Raban në Bashkinë Përmet. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rilevuar prej 4.9 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rilevime fotogrametrike 3D arrin në 180.

TRAJNIME PËR GJEONFORMACIONIN

ASIG zhvilloi më 31 korrik dhe 1 gusht 2025 trajnim me stafin teknik të Shoqërinë Rajonale Ujësllës - Kanalizime Shkodër, si dhe ofrimin e asistencës teknike për Bashkinë Malësi e Madhe, me qëllim rritjen e kapaciteteve në fushën e informacionit gjeohapësinor.

Trajnimi u fokusua në krijimin, përpunimin dhe standardizimin e të dhënave për rrjetin e ujësllës-kanalizimeve sipas standardeve kombëtare dhe prezantimin e funksionaliteteve të Gjeoportalit Kombëtar.

Asistenca për Bashkinë Malësi e Madhe u përqëndrua në përditësimin e rrjetit rrugor lokal dhe strukturimin e të dhënave për integrim në Gjeoportali, me synim mbështetjen e planifikimit vendor dhe rritjen e aksesit në informacionin gjeohapësinor.

Këto iniciativa synojnë përfundimin e kapaciteteve vendore, përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe sigurimin e një qasjeje më të gjerë dhe efektive ndaj informacionit gjeohapësinor.



BOTA E GJEONFORMACIONIT

Kompania Google prezanton AlphaEarth Foundations për monitorim global të Tokës

Kompania Google ka prezantuar AlphaEarth Foundations, një model të avancuar të inteligjencës artificiale që vepron si satelit virtual dhe integron të dhëna nga imazhet satelitore, radarët, hartat 3D dhe simulimet klimatike, duke krijuar një portret të përditësuar dhe me rezolucion të lartë të Tokës. Këto të dhëna të përpunuara publikohen në Google Earth Engine dhe përdoren për projekte si: gjurmimi i pyjeve, ndryshimet e përdorimit të tokës dhe mbulimi i ekosistemeve. Me këtë sistem, AlphaEarth përmirëson saktësinë analitike, thjeshton klasifikimet dhe detektimin e ndryshimeve, duke u bërë një mjet i rëndësishëm për biodiversitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Galileo SAR Meet 2025: BE-ja forcon kërkim-shpëtimin

Programi Hapësinor i BE-së po përforcon kërkim-shpëtimin përmes shërbimit Galileo Search and Rescue (SAR), kontribut në rrjetin global Cospas-Sarsat, që siguron zbulim të shpejtë dhe lokalizim me saktësi të lartë të sinjaleve të emergjencës, duke ndihmuar në shpëtimin e rreth 2000 jetëve çdo vit. Copernicus ofron të dhëna të hapura mbi kushtet mjedisore që përdoren për planifikimin e misioneve dhe modelet e devijimit. Aktiviteti Galileo SAR Meet 2025, i organizuar në Çeki, nga 4-8 gusht 2025, mbledhi ekiye evropiane për të testuar aftësitë, shkëmbyer përvoja dhe orientuar përmirësimet e ardhshme të shërbimit.

AKTIVITETE NË VIJIM

EFGS 2025

Shoqata Evropiane e Gjeostatistikës organizon nga 23-25 shtator 2025, në Oslo, të Norvegjisë, Konferencën Evropiane për Gjeostatistikën dhe të Dhënat Hapësinore. Ky aktivitet synon të fuqizojë përdorimin e të dhënave hapësinore të besueshme për vendimmarrje duke prezantuar zgjidhje të avancuara në fushën e gjeostatistikës dhe analizave hapësinore.

23 - 25 Shtator 2025

INTERGEO 2025

Nga data 7 - 9 tetor 2025, në Frankfurt, të Gjermanisë, do të zhvillohet panairi ndërkombëtar INTERGEO 2025, aktivitet mjaft i rëndësishëm për gjeodezinë, informacionin gjeohapësinor dhe menaxhimin e tokës. Panairi do të mbledhë ekspertë dhe institucione nga fusha si: GIS, fotogrametria, sensorët në distancë, dronët dhe qytetet inteligjente, duke promovuar zgjidhje për sfidat globale si ndryshimet klimatike dhe urbanizimi i qëndrueshëm.

7 - 9 Tetor 2025

SDQ Conference

EuroGeographics dhe EuroSDR organizojnë nga 20-21 nëntor 2025, në Athinë, të Greqisë, Konferencën për Cilësinë e të Dhënave Gjeohapësinore. Aktiviteti do të mbledhë ekspertë të fushës për të diskutuar zhvillimet më të fundit mbi saktësinë, sigurinë dhe ndërveprueshmërinë e të dhënave gjeohapësinore, si dhe përdorimin e tyre në monitorimin mjedisor, qytetet inteligjente, menaxhimin e emergjencave dhe inteligjencën artificiale.

20 - 21 Nëntor 2025

www.asig.gov.al

www.geoportal.asig.gov.al

Rruga Papa Gjon Pali II Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë;

Telefon: +355 (0)42 223 762;

E-mail: info@asig.gov.al